UDHËZIM
Nr. 10, datë 27.12.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 28.6.2019, "PËR DOKUMENTET PËR QARKULLIM DHE REGJISTRIM TË MJETEVE RRUGORE"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 80, 92–102 dhe 220–224, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të neneve 237–252, 368 dhe 370, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, "Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 4, datë 28.6.2019, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Pika 1, e nenit 14, e kreut I, riformulohet si më poshtë:

"1. Në rastet e humbjes, vjedhjes, shkatërrimit ose dëmtimit të certifikatës së pronësisë së mjetit, aplikanti paraqet në portalin unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*:

a) aplikimin dhe shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) deklarimin për humbjen e certifikatës së pronësisë, e shprehur në modelin e shkronjës "a", të pikës 1 të këtij neni"."

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku